

NR 31866/Akt
1

VENDIM
I
GJYQTARIT TE VETEM

Une, gjyqtare e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane M. Gjoni sot me date 16-11-04 pasi mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga Ministri i Ekonomise Z. Anastas Angjeli, per depozitim ne rregjistrin tregtar te Urdherit nr. 233, date 07.07.2004 "Per ndryshime ne aktet e themelimit te shoqerise "Ujesjelles-Kanalizime" Sh.a. Libohove,

KONSTATOVA:

Se Shoqeria Anonime "Ujesjelles-Kanalizime" Sh.a. Libohove eshte regjistruar si person juridik ne Gjykatën e Shkalles se Pare Tirane me Vendimin Nr. 31866, date 02.07.2004. Me urdherin nr. 233, date 07.07.2004, Ministri i Ekonomise me cilesine e aksionerit te vetem te shoqerise urdheroi ndryshime ne aktet e themelimit te shoqerise "Ujesjelles-Kanalizime" Sh.a. Libohove si me poshte:

1. Ndryshimin e aktit te themelimit te shoqerise anonime "Ujesjelles-Kanalizime" Sh.a. Libohove si me poshte:

1.1 Pika 4 riformulohet:

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 32,430,666 leke, i ndare ne 32,430 aksione me vlere nominale 1,000 leke, i cili zoterohet 100 % nga Bashkia Libohove.

2. Ndryshimin e statutit te shoqerise anonime "Ujesjelles-Kanalizime" Sh.a. Libohove si me poshte:

2.1 Neni 4 riformulohet :

Aksioneret e shoqerise

Zoterues 100% i kapitalit te shoqerise "Ujesjelles-Kanalizime" Sh.a. Libohove (aksioner i vetem) eshte Bashkia Libohove. Kjo e drejte i kalohet Bashkise Libohove nga Ministria e Ekonomise me Vendimin e Keshillit te Ministrave Nr. 173, date 26.03.2004.

2.2 Ne paragrafin e pare te Nenit 6 fjalet "Ministri i Ekonomise" zevendesohet me fjalet "Bashkia Libohove".

2.3 Ne paragrafin e shate te Nenit 9 fjalet "Ministri i Ekonomise" zevendesohet me fjalet "Bashkia Libohove".

2.4 Ne paragrafin e fundit te Nenit 17 fjalet "Ministri i Ekonomise" zevendesohet me fjalet "Bashkia Libohove".

2.5 Ne nenin 20 te statutit fjalet "Ministri i Ekonomise" zevendesohet me fjalet "Bashkia Libohove".

2.6 Ne nenin 21 te statutit fjalet "Ministri i Ekonomise" zevendesohet me fjalet "Bashkia Libohove".

Nga shqyrtimi i akteve te depozituarar rezulton se kerkesa e paraqitur eshte e bazuar dhe dokumentacioni i paraqitur me kete rast eshte i plote .

Per keto arsye :

Ne baze te ligjit nr. 7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe ligjit nr. 7667, date 28.01.1993 "Per rregjistrin tregtar dhe formalitet qe duhen plotesuar ne te"

Vendosa :

Depozitimimin ne Zyren e Rregjistrimit Tregtar te Urdherit nr. 233, date 07.07.2004 te Ministrit te Ekonomise "Per ndryshime ne aktet e themelimit te shoqerise "Ujesjelles-Kanalizime" Sh.a. Libohove.

Te behen ndryshimet perkatese ne rregjistrin tregtar ne kollonat perkatese.
Te publikohet vendimi i mesiperm
Kunder vendimit lejohet ankim.

GJYQTARE
Manoula Gashi
Elberdy



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E EKONOMISE

Drejtoria e Privatizimit te Ndermarrjeve dhe Shoqerive te Vogla e te Mesme

URDHER

NR. 233 DATE 7.7 2004

PER

NDRYSHIME NE AKTET E THEMELIMIT TE SHOQERISE ANONIME
“UJESJELLES-KANALIZIME” SH.A. LIBOHOVE.

Ne mbeshtetje te nenit 102 pika 4 te Kushtetutes te Republikes se Shqiperise, te nenit 1 te Ligjit Nr. 8885, date 22.04 2002 “Per disa ndryshime ne ligjin Nr.7926, date 20.04.1995 “Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare”, ndryshuar me akte te tjera ligjore dhe V.K.M Nr. 173 date 26.03.2004 “Per transferimin e pronave te paluajtshme shteterore te sistemit te ujesjelles-kanalizime ne pronesi te njesive te qeverisjes vendore”, me cilesine e aksionerit te vetem te shoqerise,

URDHEROJ :

1. Ndryshimin e aktit te themelimit te shoqerise anonime “Ujesjelles-Kanalizime” Sha Libohove, si me poshte:

1.1 Pika 4 riformulohet:

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 32,430,666 leke, i ndare ne 32430 aksione me vlere nominale 1,000 leke, i cili zoterohet 100 % nga Bashkia Libohove.

2. Ndryshimin e statutit te shoqerise anonime “Ujesjelles- Kanalizime” Sha Libohove, si me poshte:

2.1 Neni 4 riformulohet :

Aksioneret e shoqerise

Zoterues 100% i kapitalit te shoqerise “Ujesjelles Kanalizime” Sh.a Libohove (aksioner i vetem) eshte Bashkia Libohove. Kjo e drejte i kalohet Bashkise Libohove nga Ministria e Ekonomise me Vendimin e Keshillit te Ministrave Nr.173, date 26.03.2004.

- 2.2 Ne paragrafin e pare te Nenit 6 fjalet “Ministri i Ekonomise” zevendesohet me fjalet “Bashkia Libohove”.
- 2.3 Ne paragrafin e shtate te Nenit 9 fjalet “Ministri i Ekonomise” zevendesohet me fjalet “Bashkia Libohove”.
- 2.4 Ne paragrafin e fundit te Nenit 17 fjalet “Ministri i Ekonomise” zevendesohet me fjalet “Bashkia Libohove”.
- 2.5 Ne nenin 20 te statutit fjalet “Ministri i Ekonomise” zevendesohet me fjalet “Bashkia Libohove”.
- 2.6 Ne nenin 21 te statutit fjalet “Ministri i Ekonomise” zevendesohet me fjalet “Bashkia Libohove”.
3. Ngarkohet Drejtoria e Privatizimit te Ndermarrjeve dhe Shoqerive te Vogla dhe te Mesme dhe Drejtoria Juridike te kryeje procedurat e depozitimit ne Gjykatën e Shkalles se Pare Tirane.

Ky urdher hyn ne fuqi menjehere.



Anastas ANGJELI

MINISTER